



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

RAPORTI I GJENDJES PERINATALE NË KOSOVË PËR VITIN 2023

*Departamenti i Mjekësisë Sociale
Observatori për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe të Rinjve – IKSHPK*

RAPORTI I GJENDJES PERINATALE NË KOSOVË PËR VITIN 2023

*Departamenti i Mjekësisë Sociale
Observatori për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe të Rinjve – IKShPK*

Botuesi:

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Copyright:

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Përdorimi i të dhënave lejohet vetëm kur citohet burimi i të dhënave.

Parathënie

Publikimi “Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë për vitin 2023” përfshinë të dhënat në dispozicion të raportuara nga institucionet shëndetësore (IKSHPK) dhe Agjensioni i Statistikave të Kosovës (ASK).

Të dhënat të cilat i shfrytëzojmë për përgatitjen e Raportit të Gjendjes Perinatale nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës edhe për vitin 2023 janë të mangëta si, numri i banorëve sipas komunave, statistikave të lindjeve dhe statistikave të vdekjeve, andaj kemi prezentuar lindjet sipas të dhënave nga Departamenti i Statistikave Shëndetësore- IKShPK, dhe të dhënat në dispozicion nga ASK.

Në këtë publikim përfshihen të dhënat mbi definicionet, lindjet dhe vdekshmërinë e foshnjave të ndarë sipas periudhave të ndryshme të jetës së foshnjave. Të dhënat kryesore perinatale dhe lindjet janë të prezantuara sipas viteve 2000-2023. Lindjet janë të raportuara sipas niveleve të kujdesit shëndetësor nga institucionet shëndetësore publike dhe private. Të porsalindurit janë prezantuar sipas grup-peshës dhe mënyrës së lindjes. Foshnjat e vdekura janë të prezantuara sipas moshës, gjinisë, moshës së nënës, statusit martesor dhe nivelit të edukimit të nënës. Koeficienti i vdekshmërisë infantile është prezantuar sipas komunave, kurse koeficienti perinatal në mungesë të dhënave është prezantuar vetëm sipas vitit.

Duke pasë parasysh mangësitë në burime relevante të të dhënave lexuesit dhe ata të cilët do të përdorin këtë hulumtim këshillohen që të marrin me rezervë vlerat e fituara të indikatorëve sepse nuk ilustron në mënyrë të denjë realitetin e gjendjes perinatale në Kosovë.

Ftojme të gjithë shfrytëzuesit e këtij hulumtimi për bashkëpunim duke dhënë vërejtje, komente dhe propozime me qëllim të ngritjes së cilësisë në këtë lëmi tejet të domosdoshme për zhvillimin, planifikimin, organizimin dhe menaxhimin e sistemit shëndetësor në Kosovë në dobi të ruajtjes dhe përparimit të shëndetit të nënës dhe fëmijës.

Falenderojmë të gjitha institucionet shëndetësore të Kosovës të cilat ofruan bashkëpunim në mbledhjen e të dhënave.

Dr. Ardita Baraku

Drejtor ekzekutiv i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	6
PËRMBLEDHJE	7
DEFINICIONET	8
METODOLOGJIA	10
TË DHËNAT KRYESORE	12
LINDJET.....	14
VDEKSHMËRIA E FOSHNJEVER.....	23
VDEKSHMËRIA FETALE.....	27
VDEKSHMËRIA PERINATALE	28
PËRFUNDIMET	30
REKOMANDIMET	32
BIBLIOGRAFIA	33
ANEX	34

PËRMBLEDHJE

Gjendja perinatale përfaqëson një tregues kyç të mirëqenies së popullatës dhe efikasitetit të sistemit shëndetësor të një vendi. Periudha perinatale, që përfshin kohën nga java e 22-të e shtatzënisë deri në ditët e para pas lindjes, është një fazë kritike për mbijetesën dhe zhvillimin e foshnjës. Faktorët biologjikë, social-ekonomikë dhe politik-bërës luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e shëndetit perinatal, duke ndikuar në reduktimin e vdekshmërisë foshnjore dhe komplikimeve obstetrike. Rëndësia e shëndetit perinatal qëndron në reflektimin e gjendjes shëndetësore të vendit dhe cilësinë e sistemit shëndetësor prandaj si i tillë për nga rëndësia është paraparë edhe në objektivin e Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë.

Ky raport synon t'iu ofrojë vendimmarrësve, institucioneve shëndetësore dhe profesionistëve shëndetësorë të dhëna të përditësuara për të vlerësuar gjendjen aktuale perinatale dhe për planifikimin e ndërhyrjeve të bazuara në evidenca me qëllim të përmirësimit të gjendjes perinatale në Kosovë.

Një element i rëndësishëm i këtij raporti është përqindja e lindjeve me prerje cezariene në institucionet shëndetësore publike dhe private. Sipas të dhënave të vitit 2023, 40.5% e të gjitha lindjeve në institucionet publike dhe private janë realizuar me prerje cezariene, në institucionet private nga të gjitha lindjet e realizuara, lindje me prerje cezariene ishin 69.1%. Studimet tregojnë se aplikimi i tepruar i prerjes cezariene mund të rrisë rrezikun e komplikimeve postoperatore, infeksioneve dhe problemeve të mëvonshme obstetrike për gratë.

DEFINICIONET

Indikatori Perinatal është indikator kyç dhe senzitiv i gjendjes shëndetësore dhe reflekton kujdesin prenatal, gjatë lindjes dhe kujdesin për të porsalindurit. Poashtu reflekton si indikator i tërthortë për gjendjen shëndetësore të nënës, organizimin dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor.

Definicionet e indikatorëve janë shfrytëzuar nga “ Korniza e treguesve të shëndetit të fëmijës dhe nënës” Maj 2018 e cila është produkt i grupit punues në nivel nacional dhe i përkrahur nga Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit në Republikën e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, IKShPK dhe (United Nations Children`s Fund) Fondi i Kombeve të bashkuara për Fëmijë(UNICEF).

I lindur nënkupton shpëputjen e tërësishme të fetusit të vdekur që peshon më shumë se 500 g apo të fetusit të gjallë nga trupi i nënës pavarësisht nga kohëzgjatja e shtatzënësisë.

I lindur gjallë nënkupton shpëputjen e tërësishme nga trupi i nënës të produktit të konceptcionit, pavarësisht nga kohëzgjatja e shtatzënësisë, i cili produkt pas ndarjes, merr frymë apo tregon shenja të jetës si p.sh të rrahurat e zemrës, pulsimit të kordonit të kërthizës apo lëvizje vullnetare të muskujve, pavarësisht nëse kordoni i kërthizës është prerë apo placenta është ngjitur.

I lindur vdekur: Vdekja para daljes apo nxerrjes prej nënës së vet e produktit të konceptcionit pa marrë parasysh kohëzgjatjen e shtatzënësisë; vdekja është përcaktuar sipas faktit se pas ndarjes së tillë fetusit nuk merr frymë apo nuk tregon ndonjë shenjë tjetër jete, siç janë rrahjet e zemrës, pulsimet e kordonit umbilikal apo lëvizjet e përcaktuara të muskujve të vullnetshëm (ASK)

Shkalla e të lindurve të vdekur (Vdekshmëria fetale)

Numri i të lindurve të vdekur për 1,000 të lindur gjallë (të lindur gjallë dhe të lindur të vdekur). Vdekja e frytit mund të ndodhë para lindjes – gjatë shtatzënësisë dhe gjatë lindjes. Për qëllime të krahasimeve kombëtare, lindjet e vdekura janë të definuara si tremujor i tretë i vdekjeve fetale (≥ 500 g ose ≥ 22 javë). Për qëllime të krahasimeve ndërkombëtare, lindjet e vdekura janë të definuara si tremujor i tretë i vdekjeve fetale ($\geq 1,000$ g ose ≥ 28 javë).

Shkalla e vdekshmërisë perinatale

Numri i vdekjeve perinatale (të lindur të vdekur dhe vdekje të hershme neonatale) e shprehur për 1,000 të lindur.

Shkalla e vdekshmërisë neonatale (mortaliteti neonatal) definohet si numri i fëmijëve të lindur të gjallë që vdesin pa i mbushë 28 ditë të jetës (0-27 ditë) e shprehur për 1,000 të lindur gjallë brenda një viti kalendarik.

Vdekjet neonatale (vdekjet gjatë 28 ditëve të para të jetës së foshnjës) mund të ndahen në:

- **vdekjet e hershme neonatale**, që ndodhin brenda 7 ditëve (0-6 ditë) të para të jetës,
- **vdekjet e vonshme neonatale** që ndodhin pas ditës së 7, (7-27 ditë), por para se të përfundohet dita e 28-të.

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave (Mortaliteti infantil)

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve paraqet numrin e foshnjeve të vdekura para moshës 1 vjeçare (0-11 muaj) të shprehur për 1,000 të lindur të gjallë, në një periudhë të caktuar kohore. Vdekshmëria e foshnjave paraqet probabilitetin që fëmija të vdesë para se t'i mbushë 1 vjet për 1,000 të lindur të gjallë.

Shkalla e vdekshmërisë maternale paraqet numrin e grave të vdekura nga ndonjë shkak që lidhet me (ose është shkaktuar nga) shtatzëninë (duke përjashtuar shkaqe aksidentale apo të rastësishme) dhe vdekjet gjatë lindjes ose brenda 42 ditëve pas përfundimit të shtatzënisë, pavarësisht nga kohëzgjatja dhe vendi i shtatzënisë, e shprehur në 100,000 të lindur gjallë, për një periudhë të caktuar kohore.

Vdekje e vonshme maternale është vdekja e një gruaje nga shkaqe të drejtpërdrejta ose të tërthorta më shumë se 42 ditë, por më pak se një vit pas përfundimit të shtatzënisë.

METODOLOGJIA

Për përpilimin e raportit janë përdorur të dhënat për vitin 2023 nga ASK për statistikave vitale si dhe të dhënat e raportuara nga institucionet shëndetësore dhe të përpiluara në raporte nga Departamenti i Statistikave Shëndetësore në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK).

Regjistrimi dhe grumbullimi i të dhënave për statistikave vitale janë detajuar sipas institucioneve relevante dhe kompetente në çdo fazë të procesit.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave demografike në nivel nacional. IKShPK, gjegjësisht Departamenti i Statistikave Shëndetësore, grumbullon të dhënat e raportuara nga institucionet shëndetësore dhe bën raportimin e fenomeneve vitale përmes raporteve nga institucionet shëndetësore relevante ndërsa Departamenti i Mjekësisë Sociale gjegjësisht njësia e Observatorit të Nënës, Fëmijës dhe të Rinjëve bënë analizën e indikatorëve të disagreguar.

- ASK është përgjegjës për grumbullimin e të dhënave nëpër hapat si më poshtë: çdo institucion shëndetësor dhe zyrë e gjendjes civile ka plotësuar Fletëzat statistikore për vdekje DEM-2.
- Në baza mujore, institucionet shëndetësore dhe zyrat e gjendjes civile kanë raportuar në zyrat regjionale të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), duke dorëzuar kopjet fizike të të gjitha DEM-2 të plotësuar.
- Zyrat regjionale të ASK-së, me pasqyrën mujore të të dhënave për lindje dhe vdekje DEM-5, kanë raportuar në ASK.
- Departamenti i statistikave sociale – sektori i statistikave vitale në ASK, ka kontrolluar cilësinë dhe ka konfirmuar të gjitha të dhënat.
- Të gjitha të dhënat janë futur në programin Access në Departamentin e IT-së.
- Sektori i statistikave vitale ka kontrolluar të dhënat në databazën e vdekjeve dhe ka përpunuar të dhënat me SPSS.
- ASK ka publikuar në faqen e internetit raportin “Statistikat e vdekjeve”.
- Grumbullimin e të dhënave nga institucionet shëndetësore relevante e realizon Departamenti i statistikave shëndetësore në IKShPK, kalkulimin e indikatorëve të disagreguar sipas gjinisë, komunave, moshës si dhe prezantimin e trendit e ka realizuar, Departamenti i Mjekësisë Sociale, Njësia e Observatorit të Nënës, Fëmijës dhe të Rinjëve.

Sfidat në grumbullimin e të dhënave:

- Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) një nga sfidat kryesore është mungesa e pyetësorit të standardizuar nga tri institucionet (Agjencia e Statistikave të Kosovës, Agjencia e Regjistrimit Civil dhe Ministria e Shëndetësisë, IKShPK).
- Gjatë vitit 2019/2020 është punuar në unifikimin e formularit për raportim, megjithatë të dhënat nga ASK për vitin 2023 për lindje dhe vdekje nuk janë të kompletuara edhe pas publikimit të fundit, prandaj në raportin e gjendjes Perinatale për vitin 2023, në mungesë të të dhënave disa indikatorë të agreguar kanë diskrepancë krahasuar me vitet paraprake si dhe disa indikatorë tjerë nuk kemi pasë mundësi t'i kalkulojmë sipas gjinisë dhe komunave.
- Numri i banorëve është bazuar në prognozën e fundit të popullatës, 2022(ASK)
- Përkundër ekzistimit në fuqi të qarkores për raportim të vdekjeve maternale, si dhe kërkesës së vazhdueshme ndër vite për raportim edhe në vitin 2023 asnjë vdekje maternale nuk është raportuar nga institucionet shëndetësore. Në vitin 2023 në mungesë të të dhënave nuk ka reflektim të këtij indikatorit në Raportin Perinatal.
- Përfshirja në raportim e vdekjeve fetale sipas komunave të Kosovës është sfidë tjetër për t'u adresuar pasi që nuk ka të dhëna nga ASK.
- Mungesa e analizimit të shkaqeve të vdekjeve për vitin 2023 në nivel nacional për arsye të vonësës së publikimit gjë që reflekton në orientimin e masave intervenuese.
- Mortaliteti perinatal si indikator ndikohet prej faktorëve tjerë jashtë sistemit shëndetësor dhe jo vetëm brenda kujdesit shëndetësor.
- Në Raportin Perinatal për vitin 2023 janë përfshirë vetëm disa prej indikatorëve bazik dhe vazhdon të mbetet ende sfidë për Kosovën gjenerimi i indikatorëve të shëndetit perinatal sipas instrumentit European EURO-PERISTAT.

TË DHËNAT KRYESORE

Të dhënat perinatale kryesore për vitin 2023 në Kosovë, të raportuara nga institucionet shëndetësore publike dhe private në Departamentin e Statistikave Shëndetësore - IKShPK janë:

- 19,566, lindje (lehona)
- 19,919, foshnje të lindura
- 19,807, të lindur gjallë
- 112 të lindur vdekur
- raporti gjinor në lindje është 1079.5 meshkuj në 1,000 femra (shkalla e maskulinitetit)
- përqindja e lindjeve me prerje cezariene është 40.5 % .

Tabela 1. Të dhënat kryesore perinatale për vitin 2023

Nr	Modalitetet	2023
1	Numri i të posalindurve të lindur të gjallë (ASK)	21,654
2	Numri i vdekjeve fetale	112
3	Numri i foshnjave të vdekura(<1 vjet)	124
4	Shkalla e vdekshmërisë fetale (‰)	5.7
5	Shkalla e vdekshmërisë infantile (‰)	5.7
6	Numri i foshnjave të vdekura në javën e parë	88
7	Shkalla e mortalitetit të hershëm neonatal (‰)	4.1
8	Shkalla e mortalitetit të vonshshëm neonatal (‰)	0.6
9	Shkalla e mortalitetit post neonatal (‰)	1.0
10	Shkalla e vdekshmërisë perinatale (‰)	9.8
11	Përqindja e lindjeve me prerje cezariene (%)	40.5

Burimi: ASK- Statistikat e lindjeve, vdekjeve, 2023

Departamenti i Statistikave Shëndetësore- IKShPK, Statistikat e lindjeve, 2023

Tab.2.Të dhënat kryesore perinatale për periudhën, 2000-2023

Vitet	Të dhënat kryesore perinatale, 2000-2023							
	Numri i lindjeve	Numri i të porsalindurve të lindur të gjallë	Numri i vdekjeve fetale	Shkalla e vdekshmërisë fetale (‰)	Numri i foshnjeve të vdekura në javën e parë	Shkalla e mortalitetit të hershëm neonatal (‰)	Shkalla e vdekshmërisë perinatale (‰)	Shkalla e lindjeve me prerje cezariene (%)
2000	39,091	38,907	572	14.5	577	14.8	29.1	7.5
2001	39,578	39,506	579	14.4	574	14.5	28.7	9.1
2002	35,399	35,271	527	14.7	444	12.6	27.1	10.3
2003	31,932	31,815	517	15.9	375	11.8	27.6	11.3
2004	30,925	30,852	452	14.4	352	11.4	25.6	12.3
2005	29,056	29,055	390	13.3	262	9.02	22.1	13.9
2006	28,404	28,450	360	12.5	307	10.8	23.2	16.4
2007	27,856	27,972	319	11.3	247	8.8	20.0	17.7
2008	28,178	28,317	334	11.6	257	9.1	20.6	18.2
2009	27,718	27,833	276	9.8	267	9.6	19.3	20.1
2010	27,517	27,645	318	11.4	216	7.8	19.1	20.7
2011	27,548	27,725	252	9.0	248	8.9	17.9	21.8
2012	28,525	28,664	284	9.8	218	7.6	17.3	20.9
2013	27,069	27,277	278	10.1	170	6.2	16.3	25.2
2014	26,565	26,787	226	8.4	98	3.7	12.0	26.9
2015	24,611	24,812	177	7.1	126	5.0	12.1	27.3
2016	24,092	24,697	156	6.3	121	4.9	11.2	24.3
2017	23,563	23,402	161	6.8	132	5.6	12.4	19.0
2018	22,870	22,761	109	4.8	147	6.6	11.2	18.2
2019	21,899	21,798	101	4.6	118	5.4	10.0	20.7
2020	20,781	20,988	135	6.4	43	1.9	8.0	21.0
2021	20,654	22,830	116	5.1	64	2.8	7.9	26.5
2022	20,165	22632	133	6.5	82	3.6	10	29.2
2023	19,566	21654	112	5.7	88	4.1	9.8	40.5

Burimi: Raporti i gjendjes perinatale 2010

ASK: Statistikat e lindjeve dhe vdekjeve, 2011-2023

Departamenti i Statistikave Shëndetësore- IKShPK

LINDJET

Në vitin 2023, sipas të dhënave të ASK-së, janë raportuar gjithsej 21,654 të lindur gjallë, prej tyre 448 të lindur jashtë Kosovës, mungojnë të dhënat për të lindur vdekur.

Sipas IKShPK-së janë raportuar gjithsej 19,556 lindje (lehona), 19,919 foshnje të lindura, 19,807 të lindur gjallë dhe 112 të lindur vdekur. Numri i të lindurve gjallë më i lartë se numri i lehonave (lindjeve) spjegohet me faktin se fëmijët e lindur kanë qenë bineq apo treneq. Diferenca e numrit të të lindurve gjallë të raportuar nga ASK dhe IKShPK për vitin 2023 është 1,753 të lindur gjallë, (tab.3).

Tab.3. Raportimi i të dhënave nga dy burime të të dhënave

Institucioni	Foshnje të lindur gjallë	Të lindur vdekur
ASK	21,654	112
IKShPK	19,901	-
Diferenca	1,753	

Burimi: IKShPK, Departamenti i Statistikave Shëndetësore, lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2023

ASK: Statistikat e Lindjeve 2023

Bazuar në raportin e IKShPK- së, për vitin 2023 gjithsej ishin 19,566 lindje, sipas nivelit të kujdesit shëndetësor ku janë kryer lindjet janë si në vijim: Përqindja më e lartë e lindjeve është realizuar në Spitalet e përgjithshme me 10,011 apo 51.2%, pason Klinika Obstetrike Gjinekologjike e QKUK-së me 7,742 lindje apo 39.6%, në maternitete 51 lindje apo 0.3%, ndërsa në spitalet private (Bahceci, Amerikan, Lindja, Sirona, European Klinik dhe Fati im) 1762 lindje apo 9.0%. Në institucionet publike janë realizuar gjithsej 17,804 apo 91.0% e lindjeve, (tab.4,5, graf.1).

Tab.4. Lindjet sipas nivelit të kujdesit shëndetësor, institucionit, Kosovë- 2023


Istitucioni	Gjithsej lindje (Lehona)		Gjithsej foshnje të lindura		Prej tyre të lindura gjallë		Prej tyre të lindura pa jetë	
	N	%	N	%	N	%	N	%
QKUK	7,742	39.6	7,985	40.1	7,904	39.9	81	72.3
Spitali	10011	51.2	10087	50.6	10063	50.8	24	21.4
Maternitetet jashtëspitalore	51	0.3	51	0.3	51	0.3	0	0.0
Institucione publike	17804	91.0	18123	91.0	18018	91.0	105	93.8
Institucione private	1762	9.0	1796	9.0	1789	9.0	7	6.3
Gjithsej	19,566	100.0	19,919	100.0	19,807	100.0	112	100.0

Burimi: IKShPK, Departamenti i Statistikave Shëndetësore, lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2023

Tab.5. Lindjet në nivelin parësor shëndetësor, Kosovë - 2023

Institucioni	Komuna	Lindje (lehona)		Foshnje të lindura		Të lindur gjallë gjallë		Të lindura pa jetë	
		N	%	N	%	N	%	N	%
Materniteti jashtë spitalor	Deqan	0	0.0	0	0.0	0	0.0	-	-
Materniteti jashtë spitalor	Dragash	0	0.0	0	0.0	0	0.0	-	-
Materniteti jashtë spitalor	Drenas	3	0.0	3	0.0	3	0.0	-	-
Materniteti jashtë spitalor	Istog	0	0.0	0	0.0	0	0.0	-	-
Materniteti jashtë spitalor	Kamenicë	0	0.0	0	0.0	0	0.0	-	-
Materniteti jashtë spitalor	Klinë	0	0.0	0	0.0	0	0.0	-	-
Materniteti jashtë spitalor	Lipjan	5	0.0	5	0.0	5	0.0	-	-
Materniteti jashtë spitalor	Malishevë	0	0.0	0	0.0	0	0.0	-	-
Materniteti jashtë spitalor	Podujevë	8	0.0	8	0.0	8	0.0	-	-
Materniteti jashtë spitalor	Rahovec	18	0.1	18	0.1	18	0.1	-	-
Materniteti jashtë spitalor	Skenderaj	0	0.0	0	0.0	0	0.0	-	-
Materniteti jashtë spitalor	Suharekë	17	0.1	17	0.1	17	0.1	-	-
Materniteti jashtë spitalor	Viti	0	0.0	0	0.0	0	0.0	-	-
Materniteti jashtë spitalor	Kaçanik	0	0.0	0	0.0	0	0.0	-	-
Totali		51	0.3	51	0.3	51	0.3	-	-

Burimi: IKShPK, Departamenti i Statistikave Shëndetësore, lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2023




Graf.1 Struktura e lindjeve në institucionet publike dhe private, 2022

Burimi: IKShPK, Departamenti i Statistikave Shëndetësore, lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2023

Tab.6 Të lindurit gjallë sipas gjinisë, shkalla e maskulinitetit

Institucioni	Komuna	Gjinia				TOTALI		Shkalla e maskulinitetit në 1000
		Djem		Vajza				
		N	%	N	%	N	%	
TOTALI		10,282	51.9	9,525	48.1	19,807	100.0	1079.5

Burimi: IKShPK - Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2023




Graf.2. Struktura e të lindurve gjallë sipas gjinisë

Burimi: IKShPK - Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2023

Sipas të dhënave nga Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2023 gjithsej ishin 19,807 të lindur të gjallë prej tyre, femra 9,525 (48.1%), meshkuj 10,282 (51.9%) me koeficient të maskulinitetit në lindje 1079.5%, (tab.6, graf.2).

Sipas të dhënave nga ASK, komunat me më së shumti të lindur gjallë kishte në komunën e Prishtinës me 2,751 apo (12.7%) komunën e Prizrenit me 1,902 apo (8.8%) dhe komunën e Ferizajit me 1,549 apo (7.2%). Komunat me numrin më të vogël të të lindurve gjallë me 0.1% ishin: komuna e Parteshit, Ranillugës dhe Klllokotit, (graf.3).




Graf.3. Struktura e të lindurve gjallë sipas komunave, 2023

Burimi: ASK-Statistikat e Lindjeve, 2023

Trendi i lindjeve


Trendi i lindjeve për periudhën kohore 2000-2023 tregon ecuri të rënies së numrit të lindjeve me lëvizje variable me mesatare 0.9 %, (graf.4).



Graf.4. Trendi i lindjeve, Kosovë 2000-2023

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2023

Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore më i larti është në Klinikën Gjinekologjike Obsterike të QKUK-së me 21.2 lindje në ditë, pason Prizreni me 7.1 lindje, Mitrovica me 4.4 lindje, Gjakova me 4.3 lindje, dhe Peja me 4.0 lindje, më së paku lindje në Vushtri me 0.4 lindje në ditë, (graf.5).




Graf.5. Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore Burimi: IKShPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2023

Sa i përket të porsalindurve sipas peshës trupore në lindje me pjesëmarrje më të madhe ishte grup pesha 2500-3999g me 86.8 % dhe grup pesha 4000+g me 8.5 %. Pjesëmarrje më të vogël në lindje kishte grup pesha më pak se 1000g me 0.5%. Pesha mesatare e të posalindurve gjallë ishte 3280.9 gram, (tab.7, graf.6).

Tab.7. Numri i foshnjeve të lindura gjallë sipas peshës trupore në institucionet publike dhe private, në vitin 2023

Institucioni	Komuna / Institucioni	Pesha trupore					Gjithsej	Pesha mesatare
		Nën 1000	1000-1499	1500-2499	2500-3999	4000+		
TOTALI	N	92	271	577	17,183	1,684	19,807	3280.9
	%	0.5	1.4	2.9	86.8	8.5	100.0	

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike dhe private të Kosovës për vitin 2023



Graf.6. Përqindja e foshnjave të lindura gjallë sipas grup peshave për vitin 2023

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2023

Sipas grup-moshës së nënës pjesëmarrja më e lartë e të lindurve gjallë janë nga nënat e grup-moshës 25-29 vjet me 7,024 apo (32.4%), pasojnë të lindurit gjallë nga nënat e grup-moshës 30-34 vjet me 6,754 apo (31.2%). Mosha mesatare e nënave ishte 29 vjet, (tab.8).

Tab.8. Të lindurit gjallë sipas grup-moshave të nënës, 2023

Grup mosha e nënës										Mosha mesatare
14 e më pak	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50 e më shumë	Gjithsej	
N	2	338	3,435	7,024	6,754	3,201	764	111	25	21,654
%	0.0	1.6	15.9	32.4	31.2	14.8	3.5	0.5	0.1	100.0

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2023

Në vitin 2023 sipas të dhënave të ASK-së nga gjithsej 21,654 të lindur gjallë, 20,941 apo (96.7%) prej tyre kishin lindur nga një foshnje, 713 apo (3.3%) kanë lindur binjak dhe nuk është raportuar asnjë lindje trenjak, (tab.9).

Tab.9. Foshnje të lindura sipas numrit

Fëmijë të lindur	Një	20,941	96.7
	Binjak	713	3.3
	Trenjak	0	0.0
	Gjithsej	21,654	100.0

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2023


Në institucionet shëndetësore publike dhe private nga gjithsej 19,566 lindje të raportuara, 7,918 prej tyre apo (40.5%) janë realizuar me prerje cezariene, lindje normale gjithsej 11,648 apo (59.5%). Tab.10, graf.8.

Në institucionet publike nga gjithsej lindje 17,804, lindje normale janë realizuar 11,104 apo (62.4%), lindje me prerje cezariene 6,700 apo (37.6%). Në institucionet private nga gjithsej 1,762 lindje, 544 apo (30.9%) janë lindje normale, me prerje cezariene janë realizuar 1,218 lindje apo (69.1%), (tab.10,11, graf.7).

Tab.10. Struktura e lindjeve sipas mënyres së lindjes në institucionet publike dhe private, 2023

Mënyra e Lindjes	N	%
Lindje normale	11,648	59.5
Lindje me prerje cezariene	7,918	40.5
Gjithsej lindje	19,566	100.0

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike dhe private të Kosovës, 2023



Graf.7. Struktura e lindjeve sipas mënyres së lindjes, për vitin 2023

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike dhe private të Kosovës, 2023

Në Klinikën Gjinekologjike Obstetrike të QKUK-së, 3,003 apo (38.8%) e lindjeve janë me prerje cezariene. Sipas spitaleve, përqindja më e lartë e lindjeve me prerje cezariene është realizuar në spitalin e Pejës 688 (47.7%), pason spitali i Prizrenit 2,594 apo 42.4% dhe spitali me më pak raste të raportuara të lindjeve me prerje cezariene ishte spitali i Ferizajit me 1,273 apo (18.9%). Spitalet private nga gjithsej 1,762 lindje të raportuara 1,218 apo (69.1%) prej tyre janë realizuar me prerje cezariene, (tab.10).


Në graf.10 është analizuar ecuria e lindjeve me prerje cezariene për periudhën 2000-2022, ku shihet se lindjet me prerje cezariene kanë pësuar rritje përgjatë viteve, sidomos në vitin 2015 ishte përqindja më e lartë e lindjeve me prerje cezariene (27.3%), pason një rënie në vitin 2017, 2018 dhe prapë kemi ngritje të lehtë deri në vitin 2020, rritje e theksuar vërehet në vitin 2023 me 40.5%.

Në institucionet private përqindja e lindjeve të realizuara me prerje cezariene është 69.1%, krahasuar me vitin paraprak (86.2%) ka rënie. (tab.11, graf.8,9).


Tab.11. Lindjet me prerje Cezariane sipas institucioneve shëndetësore, Kosovë 2023

Institucioni		Komuna	Lindje me prerje cezariane		Gjithsej Lindje
			N	%	N
Institucionet Publike	QKUK	Prishtinë	3,003	38.8	7,742
	Spitali	Ferizaj	241	18.9	1,273
	Spitali	Gjakovë	477	30.3	1,575
	Spitali	Gjilan	524	38.8	1,352
	Spitali	Mitrovicë	613	37.8	1,623
	Spitali	Pejë	688	47.7	1,443
	Spitali	Prizren	1,099	42.4	2,594
	Spitali	Vushtrri	55	36.4	151
	Maternitete jashtëspitalore		0	0.0	51
Gjithsej në Institucione Publike			6,700	37.6	17,804
Institucionet Private	Bahceci Healthcare	Prishtinë	0	0.0	0
	Spitali Amerikan	Prishtinë	247	57.8	427
	Spitali "Fati im"	Prishtinë	395	79.2	499
	Spitali Olive	Prishtinë	39	83.0	47
	Spitali Lindja	Prishtinë	252	76.6	329
	Spitali European Klinik	Gjakovë	106	67.1	158
	Spitali Dream Hospital	Ferizaj	103	45.8	225
	Spitali Kestrina	Prishtinë	70	100.0	70
	Spitali United Hospital	Prishtinë	6	85.7	7
Gjithsej në Institucione Private			1,218	69.1	1,762
TOTALI			7,918	40.5	19,566

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore të Kosovës për vitin 2023



Graf.8. Struktura e lindjeve sipas mënyrës së lindjes në dhe llojit të institucioneve shëndetësore
Burimi: IKShPK – Lindjet në Institucionet shëndetësore të Kosovës për vitin 2023



Graf.9. Struktura e lindjeve me prerje cezariane për vitet, 2000-2023
Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore të Kosovës

VDEKSHMËRIA E FOSHNJAVE

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave (Mortaliteti infantil)

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave paraqet numrin e foshnjave të vdekura para moshës 1 vjeçare (0-364 ditë) të shprehur për 1,000 të lindur të gjallë, në një periudhë të caktuar kohore.


Vdekshmëria e foshnjave apo mortaliteti infantil është një nga indikatorët e ndikimit (impaktit) sepse reflekton sistemin shëndetësor, kujdesin antenatal, natal dhe pasnatal, kulturën shëndetësore dhe zhvillimin e përgjithshëm shoqëror të vendit.

Sipas të dhënave nga ASK, gjatë vitit 2023 institucionet shëndetësore kanë raportuar gjithsej 124 foshnje të vdekura, prej tyre 88 apo (71.0%) janë foshnje të vdekura prej 0-6 ditë, 14 apo (11.3%) janë foshnje të vdekura prej 7-27 ditë dhe 22 apo (17.7%) janë foshnje të vdekura prej 1-11 muaj, (tab.12, graf.10).

Tab.12. Vdekshmëria e foshnjave sipas moshës

Foshnje të vdekura	Deri në	1 – 6 ditë	7 – 27 ditë	1 – 11 muaj	Gjithsej
	24 orë				
N	44	44	14	22	124
%	35.5	35.5	11.3	17.7	100.0

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2023




Graf.10. Struktura e vdekshmërisë së foshnjave sipas moshës

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2023

Sipas të dhënave të ASK-së, mortaliteti infantil në vitin 2023 ishte 5.7%, kurse në vitin paraprak vlera e këtij indikatori ishte 5.2%.


Shkalla e mortalitetit infantil për periudhën 2002-2023 tregon rënie me lëvizje variabile me mesatare prej 0.6%, (graf.11).



Graf.11. Mortaliteti infantil, 2002-2023


Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2023

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave sipas moshës për vitin 2023 është si vijon: Mortaliteti neonatal i hershëm 4.1%, mortaliteti neonatal i vonshëm 0.6% dhe mortaliteti postneonatal 1.0%, (graf.12).



Graf.12. Vdekshmëria e foshnjave sipas moshës

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2023




Graf.13. Vdekshmëria e foshnjave sipas gjinisë

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2023

Mortaliteti infantil sipas gjinisë ishte 3.4% për meshkuj dhe 2.3% për femra (graf.13). Shkalla e vdekshmërisë së hershme neonatale në vitin 2023 ishte 4.1%, krahasuar me vitin paraprak 3.6% kemi një ngritje të lehtë.

Shkalla e vdekshmërisë së hershme neonatale për vitet 2000-2023 ka pësuar rënie me lëvizje variable me mesatare prej 0.9%, (graf.14).



Graf.14. Shkalla e vdekshmërisë së hershme neonatale

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2023

Në vitin 2023 nga gjithsej 124 foshnje të vdekura, 74 prej tyre janë meshkuj dhe 50 femra. Vdekshmëria e foshnjave sipas moshës së nënës dominon mosha 25-34 vjet me 68 foshnje të vdekura.(tab.13).

Tab.13. Vdekshmëria e foshnjave sipas moshës, gjinisë, moshës së nënës

Modalitete		Gjithsej	Mosha e foshnjave të vdekura		
			0-6 ditë	7-27 ditë	28-364 ditë
Gjinia	Meshkuj	74	50	10	14
	Femra	50	38	4	8
	Gjithsej	124	88	14	22
Mosha	15-24	19	15	1	3
	25-34	68	46	9	13
	35+	37	27	4	6
Gjithsej		124	88	14	22
%		100.0	71.0	11.3	17.7

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2023

VDEKSHMËRIA FETALE

Vdekshmëria fetale paraqet numrin e të lindurve të vdekur për 1,000 të lindur gjallë (të lindur vdekur në raport me të lindur gjallë). Vdekja e frytit mund të ndodhë para lindjes, gjatë shtatzënësisë dhe gjatë lindjes.

Në vitin 2023 sipas IKShPK-së, departamentit të Statistikave Shëndetësore, numri i foshnjave të lindura pa jetë ka qenë 112, me vdekshmëri fetale 5.7%.


Sipas niveleve të Kujdesit Shëndetësor 81 vdekje fetale apo (72.3%) kanë ndodhë në QKUK, 24 apo (21.4%) në spitale, në institucione private janë raportuar 7 raste të lindura pa jetë apo 6.3%, (tab.14).

Tab.14. Foshnjat e lindura pa jetë sipas institucioneve shëndetësore, 2023

Nr	Institucioni	Prej tyre të lindur pa jetë	
		N	%
1	QKUK	81	72.3
2	Spitalet e përgjithshme	24	21.4
3	Maternitetet jashtëspitalore	0	0.0
4	Institucionet publike	105	93.7
5	Institucionet private	7	6.3
6	Gjithsej	112	100.0

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike dhe private të Kosovës për vitin 2023

Sipas të dhënave të raportuara në departamentin e Statistikave Shëndetësore, në nivelin terciar në QKUK, në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike, vdekshmëria fetale është më e larta me 11%. Sa i përket spitaleve rajonale, spitalet me shkallën më të lartë të vdekshmërisë fetale janë: spitali i Gjilanit me 6.4% dhe Pejës me 3.7%. Spitali i Ferizajit dhe Vushtrisë nuk kanë raportuar asnjë rast të vdekjeve fetale, (tab.13, graf.15).



Graf.15. Vdekshmëria fetale sipas institucioneve shëndetësore publike

Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2023

Vdekshmëria fetale për periudhën 2000-2023 ka trend të rënies me lëvizje variabile me mesatare prej 0.7‰. Në vitin 2000 shkalla e vdekshmërisë fetale ishte 14.5‰ ndërsa në vitin 2023 është 5.7‰, krahasuar me vitin paraprak (6.5‰) kemi rënie të lehtë. Nëse analizohet situata gjatë viteve shihet se është punuar në përmirësimin e gjendjes perinatale, (graf.16).



Graf.16. Shkalla e vdekshmërisë fetale, 2000-2023


Burimi: IKShPK- Lindjet në Institucionet shëndetësore publike dhe private të Kosovës për vitin 2023

VDEKSHMËRIA PERINATALE

Vdekshmëria perinatale pasqyron vdekshmërinë fetale dhe vdekshmërinë e hershme neonatale së bashku për një periudhë të caktuar kohore në territor të caktuar.

Në vitin 2023 në Kosovë, shkalla e vdekshmërisë perinatale ishte 9.8‰ (vdekshmëria fetale 5.7 ‰ dhe vdekshmëria e hershme neonatale 4.1‰), dallimi me vitin paraprak ishte 0.2‰ që është dallim shumë i ndjeshëm.

Sipas të dhënave në dispozicion nga ASK, mortaliteti perinatal për periudhën 2000-2023 tregon tendencë të rënies me lëvizje variabile me mesatare prej 1‰, (graf.17).



Graf.17. Trendi i mortalitetit perinatal, 2000-2023

Burimi: Raporti i gjendjes perinatale, 2010

ASK, Statistikat e Vdekjeve dhe lindjeve 2000-2023

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave (‰) sipas moshës për vitin 2023:

Vdekshmëria e hershme neonatale (0 – 6 ditë) 3.6‰.

Vdekshmëria neonatale e vonshme (7 – 27 ditë) 0.8‰.

Vdekshmëria postneonatale (28 - 364 ditë) 0.8‰.

Tab.15. Indikatorët demografikë në Kosovë sipas komunave, 2022

Komuna	Nataliteti	Mortaliteti	Mortaliteti infantil	Shtimi natyror
Deçan	8.2	4.8	14.3	-1.3
Gjakovë	11.3	6.1	4.8	-0.9
Gllogoc	14.3	3.8	1.2	6.8
Gjilan	15.4	8.1	7.4	-0.9
Dragash	8.1	6.0	0.0	-4.0
Istog	10.5	5.5	4.6	-0.6
Kaçanik	12.2	4.4	4.7	3.3
Klinë	11.7	4.8	6.4	2.0
Fushë Kosovë	17.8	5.3	5.7	7.2
Kamenicë	11.6	9.4	0.0	-7.2
Mitrovicë Jugore	13.7	6.5	4.3	0.8
Mitrovicë Veriore	4.5	4.8	0.0	-5.1
Leposaviq	15.2	4.4	0.0	6.5
Lipjan	14.3	9.6	0.0	-4.9
Novobërdë	23.1	7.2	2.5	8.6
Obiliq	12.2	4.7	3.0	2.9
Rahovec	10.8	6.0	5.8	-1.2
Pejë	13.5	5.2	12.1	3.0
Podujevë	13.0	4.9	6.7	3.1
Prishtinë	9.9	4.7	3.6	0.5
Prizren	12.0	5.0	4.7	1.9
Skënderaj	16.7	5.6	4.4	5.5
Shtime	17.6	19.7	9.0	-21.7
Shtërpçë	11.8	5.6	4.5	0.6
Suharekë	14.6	5.5	9.8	3.7
Ferizaj	11.3	5.0	3.7	1.2
Viti	16.0	6.2	4.1	3.7
Vushtrri	10.4	6.8	0.0	-3.1
Zubin Potok	6.8	9.7	0.0	-12.7
Zveçan	13.3	3.9	5.4	5.5
Malishevë	5.9	5.2	0.0	-4.4
Junik	13.3	4.0	0.0	5.3
Mamushë	11.3	4.1	8.8	3.2
Hani i Elezit	12.1	11.8	0.0	-11.5
Graçanicë	7.2	11.5	0.0	-15.8
Ranillug	14.5	21.7	0.0	-28.9
Partesh	14.1	10.4	0.0	-6.7
Klllokot	13.1	11.2	0.0	-9.3
Gjithsej	12.8	5.6	5.2	7.3

Burimi: ASK: Vlerësim popullsia e Kosovës, 2022

Statistikat e Lindjeve dhe statistikat Vdekjeve, 2022

*Në mungesë të të dhënave për numrin e banorëve sipas komunave për vitin 2023, indikatorët janë për vitin 2022

PËRFUNDIMET

- Në vitin 2023, kemi dallim në raportim të lindjeve si pasojë e mos unifikimit të formularëve për mbledhjen e të dhënave nga institucionet relevante. Sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, janë raportuar gjithsej 21,654 foshnje të lindur gjallë, prej tyre 447 jashtë Kosovës. Sipas të dhënave të Departamentit të Statistikave Shëndetësore, në vitin 2023 prej gjithsej lindjeve në Kosovë, 19,807 ishin të lindur gjallë dhe 112 të lindur vdekur. Përqindja më e lartë e lindjeve është realizuar në Spitalet e përgjithshme me 10,011 apo 51.2%, pason Klinika Obstetrike Gjinekologjike e QKUK-së me 7,742 lindje apo 39.6%, ndërsa në spitalet private (Bahceci, Amerikan, Lindja, Sirona, European Klinik dhe Fati im) 1762 lindje apo 9.0%. Në maternitete 51 lindje apo 0.3%, ky numër i vogël i lindjeve është pasojë e mos shfrytëzimit të kapaciteteve të resurseve. Në institucionet publike janë realizuar gjithsej 17,804 apo 91.0% e lindjeve.
- Në vitin 2023 ka rritje të lindjeve me prerje cezariene, ku në institucionet shëndetësore publike dhe private 40.5% të lindjeve janë kryer me prerje cezariene, krahasuar me vitin paraprak 29.2% kemi rritje të theksuar të lindjeve të kryera me prerje cezariene (40.5%). Kjo tregon një trend në rritje të përdorimit të kësaj metode me theks të veçantë në institucionet private.
- Vërehet një rënie e vazhdueshme e numrit të lindjeve në periudhën 2000-2023, me një mesatare prej 0.9 ‰, që mund të jetë rezultat i faktorëve socio-ekonomikë dhe ndryshimeve kulturore.
- Sa i përket të porsalindurve sipas peshës trupore në lindje, 86.8% e foshnjave kishin peshë trupore normale (2500-3999g), çka tregon për një menaxhim të duhur të shëndetit prenatal, ndërsa grupi i foshnjave me peshë të ulët mbetet i vogël. Pjesëmarrje më të vogël në lindje kishte grup pesha më pak se 1000g me 0.5%. Pesha mesatare e të porsalindurve gjallë ishte 3280.9 gram.
- Mosha mesatare e nënave është mosha 29 vjeçare.
- Sipas të dhënave nga ASK, gjatë vitit 2023 institucionet shëndetësore kanë raportuar gjithsej 124 foshnje të vdekura, prej tyre 88 apo (71.0%) janë foshnje të vdekura prej 0-6 ditë, 14 apo (11.3%) janë foshnje të vdekura prej 7-27 ditë dhe 22 apo (17.7%) janë foshnje të vdekura prej 1-11 muaj.
- Mortaliteti infantil ka shënuar një rënie të qëndrueshme, me lëvizje variabile me mesatare 0.5‰. Gjatë dy dekadave të fundit, gjë që tregon për përmirësimin e kushteve të kujdesit shëndetësor prenatal dhe postnatal në Kosovë. Mortaliteti infantil në Kosovë për vitin 2023 është 5.7‰. Shkalla e vdekshmërisë sipas moshës është si vijon: mortaliteti neonatal i hershëm 4.1‰, mortaliteti neonatal i vonshëm 0.6‰ dhe mortaliteti postneonatal 1.0‰.
- Vdekshmëria fetale për periudhën 2000-2023 ka trend të rënies me lëvizje variabile me mesatare prej 0.7‰.
- Mortaliteti perinatal për periudhën 2000-2023 tregon tendencë të rënies me lëvizje variabile me mesatare prej 1‰.

REKOMANDIMET

- Sipas udhëzimit administrativ (UA) nr.11/2013 të Ministrisë së Shëndetësisë, të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private janë të obliguara të raportojnë të dhënat perinatale sipas komunave.
- Formularët e unifikuar për mbledhjen e të dhënave mes institucioneve relevante, nga Agjencioni i statistikave të Kosovës, Agjencia e Regjistrimit Civil, Ministria e Shëndetësisë, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, të aplikohen në praktikë.
- Urgjentisht MSH duhet përmes qarkores të sigurohet niveli i raportimit të të dhënave për vdekjet maternale dhe shkaqet e vdekjeve të foshnjave.
- Institucionet shëndetësore relevante të raportojnë numrin e aborteve sipas diagnozave.
- Të organizohen trajnime të punëtorëve shëndetësorë për kodimin e shkaqeve të vdekjeve.
- Të fuqizohet qasja multidisciplinare në përmirësimin e kujdesit prenatal, kujdesit natal përmes organizimit të aktiviteteve sipas pakos së OBSH-së “Every Newborn action plan to end preventable deaths”.
- Të hartohen udhërrëfyesit dhe protokollet klinike relevante dhe të monitorohet zbatimi i tyre në praktikë.
- Të realizohet vlerësimi i cilësisë së institucioneve shëndetësore që ofrojnë kujdes shëndetësor për nëna dhe fëmijë.
- Planifikimi të bëhet komfor të gjeturave nga vlerësimi i performancës së institucioneve shëndetësore që ofrojnë kujdes shëndetësor për nëna dhe fëmijë.
- Në institucione shëndetësore të fuqizohet edukimi i vazhdueshëm profesional i punëtorëve shëndetësor.
- Programi i vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë të vazhdohet në të gjitha komunat e Kosovës.
- Të përmirësohet infrastruktura, pajisjet dhe furnizimi me barna në institucione që ofrojnë kujdes shëndetësor për nëna dhe fëmijë.
- Të organizohen takime të rregullta profesionale multidisciplinare për të prezantuar dhe diskutuar çështjet për kujdesin shëndetësor të nënës dhe fëmijës.
- Të përforcohet koordinimi dhe bashkëpunimi në mes të autoriteteve qeveritare shëndetësore qendrore dhe atyre lokale, organizatave qeveritare dhe joqeveritare si vendore ashtu edhe ndërkombëtare, asociacioneve të tjera profesionale dhe shoqërisë civile.
- Të punohet në ngritjen e nivelit të njohurive për shëndetin e nënës dhe fëmijës përmes programeve dhe aktiviteteve të promovimit dhe edukimit shëndetësor në Kosovë.
- Të përkrahet edukimi shëndetësor për shtatzënat, prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes.

BIBLIOGRAFIA

1. IKSHPK, Raporti i lindjeve në institucionet shëndetësore për vitin 2023
2. ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2023
3. ASK, Statistikat e Vdekjeve në Kosovë, 2023
4. ASK, Vlersim popullsia e Kosovës, 2022
5. Raporti i gjendjes perinatale, 2010
6. Raporti i gjendjes perinatale, 2012
7. Raporti i gjendjes perinatale, 2022

<https://zqm.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/korniza%20e%20regjuesve%20te%20shendetit%20te%20femijes%20dhe%20nenes.pdf>

ANEKS

Të dhënat demografike, 2022-Kosovë

Komuna	Banorë	Lindur gjallë	Vdekur	Vdekje më pak se 1 vit	Nataliteti	Mortaliteti	Mortaliteti infantil	Shtimi natyror
Deçan	42,642	349	203	5	8.2	4.76	14.3	-1.3
Gjakovë	92,021	1039	561	5	11.3	6.10	4.8	-0.9
Glogoc	60,518	863	227	1	14.3	3.75	1.2	6.8
Gjilan	70,587	1085	574	8	15.4	8.13	7.4	-0.9
Dragash	33,218	268	200	0	8.1	6.02	0.0	-4.0
Istog	41,348	435	229	2	10.5	5.54	4.6	-0.6
Kaçanik	34,753	424	154	2	12.2	4.43	4.7	3.3
Klinë	40,164	469	194	3	11.7	4.83	6.4	2.0
Fushë Kosovë	39,112	698	209	4	17.8	5.34	5.7	7.2
Kamenicë	24,675	287	232	0	11.6	9.40	0.0	-7.2
Mitrovicë Jugore	67,652	929	437	4	13.7	6.46	4.3	0.8
Mitrovicë Veriore	12,828	58	62	0	4.5	4.83	0.0	-5.1
Leposaviq	57,242	872	251	0	15.2	4.38	0.0	6.5
Lipjan	6,993	100	67	0	14.3	9.58	0.0	-4.9
Novobërdë	17,251	398	125	1	23.1	7.25	2.5	8.6
Obiliq	54,750	669	256	2	12.2	4.68	3.0	2.9
Rahovec	96,136	1037	574	6	10.8	5.97	5.8	-1.2
Pejë	79,631	1075	418	13	13.5	5.25	12.1	3.0
Podujevë	217,816	2831	1075	19	13.0	4.94	6.7	3.1
Prishtinë	195,326	1924	916	7	9.9	4.69	3.6	0.5
Prizren	52,881	633	265	3	12.0	5.01	4.7	1.9
Skënderaj	26,935	450	151	2	16.7	5.61	4.4	5.5
Shtime	6,310	111	124	1	17.6	19.65	9.0	-21.7
Shtërpçë	56,293	666	316	3	11.8	5.61	4.5	0.6
Suharekë	104,338	1526	572	15	14.6	5.48	9.8	3.7
Ferizaj	48,013	542	242	2	11.3	5.04	3.7	1.2
Viti	60,888	977	375	4	16.0	6.16	4.1	3.7
Vushtri	5,464	57	37	0	10.4	6.77	0.0	-3.1
Zubin Potok	7,182	49	70	0	6.8	9.75	0.0	-12.7
Zveçan	55,819	741	218	4	13.3	3.91	5.4	5.5
Malishevë	5,414	32	28	0	5.9	5.17	0.0	-4.4
Junik	5,804	77	23	0	13.3	3.96	0.0	5.3
Mamushë	10,054	114	41	1	11.3	4.08	8.8	3.2
Hani i Elezit	12,201	148	144	0	12.1	11.80	0.0	-11.5
Graçanicë	3,732	27	43	0	7.2	11.52	0.0	-15.8
Ranillug	1,660	24	36	0	14.5	21.69	0.0	-28.9
Partesh	2,687	38	28	0	14.1	10.42	0.0	-6.7
Kllokot	11,882	156	133	0	13.1	11.19	0.0	-9.3
Gjithsej	1,762,220	22632	9845	117	12.8	5.6	5.2	7.3

Burimi: ASK, Vlerësim popullsia e Kosovës, 2022

Statistikat e Lindjeve dhe statistikat Vdekjeve, 2023

*Në mungesë të të dhënave për numrin e banorëve sipas komunave për vitin 2023, indikatorët janë për vitin 2022